

UDHËZIM
Nr. 7, datë 26.3.2015

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2015

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2013 “Për krijimin e IZHA-së”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë si më poshtë vijon:
 - a) Gjuhë e huaj, 6 qershor 2015;
 - b) Gjuhë shqipe, 11 qershor 2015;
 - c) Matematikë, 16 qershor 2015.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”, do të zhvillohet më datën 18 qershor 2015.
3. Testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.
4. Lista e gjuhëve të huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht.
5. Nxënësit e klasave të IX-ta parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe: italiane, gjermane dhe franceze, janë të lirë të zgjedhin midis gjuhës së huaj të parë që kanë filluar në klasën e III-të dhe gjuhës së huaj të seksionit përkatës të filluar në klasën e VI-të.
6. Testi i gjuhës së huaj për nxënësit e klasave të IX-ta parapërgatitore, për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze, të hartohet dhe të korrigjohet në bashkëpunim me mësuesit e huaj dhe shqiptarë të këtyre seksioneve.
7. Provimet kombëtare të arsimit bazë të fillojnë në orën 10.00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.
8. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procesin e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2015”.
9. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën “gjuhë amtare”, përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën ditën e provimit.
10. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
11. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
12. Për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, drejtorja e institutit tërheq testin nga AKP, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
13. Nxënësi mbetet në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
14. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
15. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.
16. Sektori i statistikës i DAR/ ZA-së merr nga QVT-ja dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet e lirim. Këto të dhëna dërgohen në AKP, ISHA dhe MAS.

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla